

## METAFORA NË KRAHASIMIN IDIOMATIK

EVIS ÇELO

Universiteti i Vlorës, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Vlorë, SHQIPËRI  
eviscelo@yahoo.com

AKTET V, 4: 634-640, 2012

### PËRMBLEDHJE

Artikulli shtron në diskutim dy çështje që kanë të bëjnë me (a) deformimin e shprehjeve normative si në komunikim oral, ashtu edhe atë të shkruar; (b) metaforën konceptuale në krahasimin idiomatik; dhe (c) zbatimin e tyre në një eksperiment me studentë të gjuhës angleze. Ndahet në dy pjesë: në pjesën teorike për fjalët e urta (metaforta konceptuale) dhe në pjesën praktike, përdorimi i tyre në mësimin e gjuhës angleze. Pasi shpjegohet kuptimi i fjalëve të urta si njësi frazeologjike gjuhësore (idiomatike) dhe si njësi mikrostrukturale artistike kalohet në praktikimin e tyre. Metafora konceptuale në krahasimin idiomatik të fjalëve është një formë tjetër ndihmëse për përvetësimin e tyre. E udhëhequr nga parimi se kuptueshmëria e trajtave të ngurosura gjuhësore, siç janë fjalët e urta, jam e bindur se në këtë mënyrë, ndihmohet shumë zotërimi edhe i konstruksioneve gramatikore dhe përdorimi i drejtë i tyre në jetën e përditshme. Për këtë arsye parashihet si e domosdoshme që në orën e mësimin, për t'i mëshuar teorikisht problematikës në fjalë, të përdoren mjete ndihmëse, si tabela dhe kontekste. Metoda e punës mund të zbatohet jo vetëm në zotërimin më lehtë të gjuhës angleze, por edhe të gjuhëve të tjera të huaja.

**Fjalët kyçe:** metaforë konceptuale, mikrostrukturë letrare, idiomë, kontekst, praktikë gjuhësore.

### SUMMARY

This article attempts to give some effective ways and methods for EFL and specifically toward Albanian students in assimilating idioms and proverbs. The technique of Conceptual metaphor in idiomatic comparison doesn't serve as a ready-made recipe but comes as a self-assessment of what we know and what we should learn. It also help students how to avoid such difficulties in the way how these prefabricated multi-word expressions must be acquired. They must be acquired as wholes in the same way as individual words, thus teacher should be democratic in evaluating every technique and strategies applied. Actually through the process of English assimilation, but even through numerous translations, the Albanian as students and as masterful of this language, firstly confront it's lexical-semantic structure. The lexical structures of both languages English and Albanian themselves mean all the lexical and phraseological treasure. English language as Lingua franca is filled with idioms, fixed expressions, phrasal-verbs and proverbs. These expressions are essential to be reached through the idiomatic comparison and metaphor in the body of the sentence. In order to have a successful communication and they need to be learned effectively by EFL students as well as Albanian ones. Possessing this kind of enrichment mutually, from one language to another reveals too many problems through the teaching process. As far as students vary a lot, a general instructive method, couldn't have benefits in all the students, so there come the teacher's role as a leader, teaching the proper items. As Roman Herzog (federal) said "The human acknowledge society doesn't need to learn, but learn what we need" **Key words** : Conceptual metaphor; literal similarities; diacronic approach; the speaker guess.

### HYRJE

Në punimin tonë shtrohen në diskutim tri çështje që kanë të bëjnë me (a) përbërjen kuptimore të fjalëve të urta dhe idiomave; (b) metaforën konceptuale në krahasimin idiomatik; dhe (c)

zbatimin e tyre në një eksperiment me studentë të gjuhës angleze. Ndaj edhe artikulli është i ndarë në dy pjesë: në pjesën teorike për fjalët e urta dhe në pjesën praktike të përdorimit të tyre në mësimin e gjuhës angleze. Pasi shpjegohet

kuptimi i fjalëve të urta si njësi frazeologjike gjuhësore (idiomatike) dhe si njësi mikrostrukturale artistike të letërsisë gojore kalohet në praktikimin e tyre.

Metafora konceptuale në krahasimin idiomatik të fjalëve të urta është një tjetër formë ndihmëse për përvetësimin e tyre. Unë udhëhiqem nga parimi se kuptueshmëria i trajtave të ngurosurat gjuhësore përmes këtyre praktikave, siç janë fjalët e urta, ndihmon shumë në zotërimin e konstrukcioneve gramatikore dhe në përdorimin e tyre të drejtë në jetën e përditshme.

Për këtë arsye parashihet si e domosdoshme që në orën e mësimit, për t'i mëshuar teorikisht problematikës në fjalë, të përdoren mjete ndihmëse, si tabela dhe kontekste. Përmes kësaj mënyre të punës është arritur një eksperiment me studentët, ta imagjinojnë situatën kontekstuale të saj, ta përdorin në kontekst të përshtatshëm, sidomos në rastin e shfaqjes së metaforës konceptuale, në mënyrë që ligjërimi të funksionalizohet rrjedhshëm.

### 1. Të ndryshosh qëndrimet ndaj gjuhës

Shkrimtarë dhe lexues të mirarsimuar në gjuhën angleze po bëhen edhe më të ndjeshëm për çështje të tilla se ç'është parë si korrekte ose e pranueshme në përdorimin e mjeteve praktike për zotërimin e gjuhës së huaj, në rastin tonë konkret të gjuhës angleze. Disa mënjanimë nga rregullat gramatikore të së kaluarës, tashmë janë pranuar jo vetëm në gjuhën e folur, por edhe në gjuhën e shkruar. Ndryshime të tilla çojnë në ndryshime në rrafshin emërtues dhe hapin rrugë për krijime të reja frazeologjike a idiomatike. Ja disa shembuj:

(a) *Who shall I ask / Kë të pyes?*. Kjo strukturë gjuhësore ka nisur të shfaqet në anglishten e shkruar. Ajo zëvendëson formën "Whom shall I ask / Cilin të pyes?". Kemi përplasje në rasë: *emërore/kallëzore*;

(b) Konstrukcioni gjuhësor "*Neither of them are coming / askush prej tyre nuk do të vijë* " po përdoret dendur në vend të "*Neither of them is coming / askush nuk po vjen*". Me këtë rast kemi përplasje në numër, zhdukje të përemrit dhe

ndryshim të kohës së foljes: *e ardhshme / e tashme*;

(c) "*I never heard of her before*" (Unë kurrë nuk kam dëgjuar /më parë/ për të) në vend të "*I have never heard of her*" (Unë kurrë nuk kam dëgjuar prej saj). Kemi përplasje kundrinore.

Parafjalët tani shfaqen shumë shpesh, pothuajse rregullisht në fund të fjalisë në anglishten e shkruar, dukuri që më parë ka qenë më se e zakonshme në anglishten e folur, por që njëkohësisht konsiderohet si një stil i keq në të shkruarën. Shembujt e mësipërm lehtësisht mund të gjenden edhe në ato gazeta që kanë bërë emër mjaft të mirë në shkrimin korrekt të anglishtes.

Qëndrimet përkundrejt stilit gjithashtu janë duke u bërë edhe më fleksibël. Fjalët të cilat ishin konsideruar si "slang" në të shkruar, mund të jenë më të pranueshme në anglishten e ditëve të sotme. Ato tashmë shihen si *colloquial or informal (si gjuhë e përditshme ose informale)*.

Shprehja "*to be browned off with somebody*" ishte në të shkuarën një *shprehje slang* (zhargon), për të shprehur "të mërzitshmen... ose irritimin me...". Përderisa i njëjti kuptim në shprehjen "*to be cheesed with smb*" ka hyrë në gjuhë dhe "*to be browned off*" përgjithësisht është ngritur në status që tani nga shumica e njerëzve të të konsiderohet informale dhe jo slang (zhargon). Kjo gjithashtu i detyrohet pjesërisht futjes në përdorim të fjalëve tabu (taboo) ose fjalëve të betimit (swear words), të cilat shumë lirshëm zëvendësojnë fjalët si ("*damn* ta hajë dreqi dhe *bloody* shumë farë / jashtëzakonisht").

### 2. Rritja dhe ndryshimi i fjalorëve të gjuhës angleze

Ashtu si në të gjitha gjuhët e botës edhe në anglishte dhe në shqipe vërehet lehtë zhvillimi diakronik. Pjesa më e lëvizshme dhe më e hapur për ndryshime të drejtpërdrejta e të menjëhershme është sistemi leksikor e semantik. Në gjuhë hyjnë fjalë të reja dhe kuptime të reja. Anglishtja, si gjuhë e popujve shumë të zhvilluar, që e përcakton rrjedha e zhvillimeve të gjithanshme në mbarë botën është shumë më

prodhimtare se shumë gjuhë të tjera që janë me një status më të privilegjuar se shqipja.

(1) Pasurimi leksikor: Nuk është e nevojshme të jesh një ekspert gjuhësor për të kuptuar se gjuha zhvillohet e pasurohet vazhdimisht. Ide të reja kërkojnë dhe kanë emërtime të reja. Pa emërtime të tilla, komunikimi i këtyre ideve të reja mund të duket i pamundur. Shumica e fjalëve të reja vijnë nga shkencat, nga teknologjia, nga sociologjia, nga politika dhe nga ekonomia.

(2) Pasurimi semantik: Fjalët që tashmë ekzistojnë, mund gjithashtu të marrin një kuptim të veçantë në një situatë të veçantë. Për shembull *“to lock someone out”* zakonisht ka kuptimin *“të mbyllësh derën me qëllim që të ndalosh dikë të hyjë”*.

### 3. Metafora

Një nga mjetet më të fuqishme dhe më prodhimtare për shndërrimin e sintagmave të lira në frazeologji a në idioma është metafora (Thomai, 158). Lakoff & Johnson metaforën e vështrojnë të ndarë në dy kategori: në *metaforë konceptuale* dhe në *metaforë leksikore* (linguistike).

Metaforika e tekstit është shumë mirë e ndërthurur në letërsi (shih për shembull Mc Closkey, 1983; Henderson, 1982). Gjithsesi, metaforat e përdorura variojnë midis gjuhëve në të dyja nivelet: në atë konceptual dhe në atë leksikor. Metafora konceptuale operon në nivel njohjeje duke aktivizuar lidhje midis fushave të ndryshme konceptuale. Këto fusha më pas janë të pasqyruara gjuhësisht me mjete leksikore. Deignan et al (1997) propozon katër kategori:

- (a) koncept metaforik i njëjtë dhe shprehje linguistike e njëjtë;
- (b) koncept i njëjtë, por shprehje linguistike e ndryshme;
- (c) metafora konceptuale të ndryshme në të dy gjuhët;
- (d) shprehje që kanë ngjashmëri literale, por kuptime metaforike të ndryshme.

Këta autorë argumentojnë nevojën e zhvillimit të të kuptuarit të natyrës metaforike të disa zhanreve specifike. Kovecses & Szabo i mëshojnë faktit se shpesh haset një lidhje konjitive midis

fushës së njohurive (d.m.th metaforës konceptuale), e cila motivon lidhjet e fjalëve të veçanta në një tekst të dhënë. Një shembull i mirë i këtij konceptimi në fushën ekonomike do të jetë fusha me emërtimet e mëposhtme *liquidity squeeze* / rënia e të ardhurave; *credit crunch* / rënia kredisë monetare; *monetary tightening* / shtrëngim i sistemit monetar, ku tri shprehje metaforike janë përdorur për të shprehur të njëjtin kuptim simbolik.

### 4. Metafora në krahasimin idiomatik

Kërkimet psikolinguistike kanë treguar se njohuritë mbi metaforën konceptuale si *“anger is heated fluid in a container”* (zemërimi është një lëng i nxehtë i rezervuar), në mënyrë të pjesshme motivojnë mënyrën e shfaqjes së kuptimit të tyre në frazat idiomatike (Kujtojmë këtu *“blow your stack”* / humbas durimin; *flip your lid* / të kalosh në fazë, të çmendesh”). Një ide e rëndësishme në shkencat e njohura bashkëkohore është ajo që metaforën nuk e shohin vetëm si një aspekt i gjuhës, por si strukturë përbërëse e një pjese sinjifikative të njohjes njerëzore (Gibbs, 1994: 33; Johnson, 1987: 47; Lakoff & Johnson, 1980: 67; Sweetser, 1990: 58).

Shumë koncepte veçanërisht abstrakte, janë pjesërisht të ndërtuara me hartën e informacionit metaforik, prej një sfere burimore të njohur në një sferë më pak të njohur. Për shembull, njerëzit shpesh konceptojnë metaforikisht mbi dashurinë, duke hartuar njohuritë e udhëtimeve fizike me ato të njohurive për dashurinë (*Love is a journey* / dashuria është një udhëtim).

Konceptimi ynë për dashurinë motivon në mënyrë të pjesshme kreativitetin dhe shprehjet gjuhësore të gjetura në përdorimin e përditshëm apo në letërsi, të cilat i referohen dashurisë dhe marrëdhënieve dashurore. P.sh. *Our marriage is off to a great start* / Martesa jonë është në fund të një fillimi të madh; *Their relation ship is at a cross-roads* / Marrëdhënia e tyre është në kryqëzim; *Her marriage is on the rock* / Martesa e tij është në rrezik; *After seven years of marriage, we’re spinning our wheels, and We’re back on the track again* / Pas shtatë vjetësh martese, ne na janë shpuar gomat dhe tani jemi prapë në vagon.

Çfarë roli luan mendimi metaforik në përdorimin dhe kuptimin e gjuhës? Rreth kësaj pyetjeje janë dhënë përgjigje të shumta e të ndryshme. Midis tyre, sispas Gibbsit, mund të gjenden të paktën katër tipa të ndryshëm hipotezash që i adresohen pyetjes së shtruar (Gibbs, 1994):

1. Mendimi metaforik luan disa role në evoluimin historik të domethënies së fjalëve dhe të shprehjeve.

2. Mendimi metaforik motivon kuptimet linguistike që kanë përhapje edhe brenda komunitetit linguistik ose nënkupton a mëton të ketë më shumë role në të kuptuarit e gjuhës.

3. Mendimi metaforik motivon përdorimin individual të folësit dhe të të kuptuarit, sepse fjalë dhe shprehje të ndryshme nënkuptojnë atë që ato shfaqin.

4. Mendimi metaforik funksionon në përdorimin e menjëhershëm on-line dhe në perceptimin (në të kapurit) e kuptimit linguistik.

Këto hipoteza nuk janë dyanëshmërisht ekskluzive për njëra – tjetrën, por mundësisht reflektojnë hirerarki të ndërveprimit midis pjesëve lidhëse të metaforës së mendimit dhe aspekteve të ndryshme të përdorimit gjuhësor dhe të kuptimit të tyre. Disa lloje evidencash të njohura empirike nga linguistika dhe psikolinguistika përkrahin disa nga këto ide. Studimet linguistike për rolin e metaforës në ndryshimet semantike përkrahin hipotezën 1 (Sweetser 1990), ndërkohë që kërkime të tjera në semantikën e shprehjeve të ndryshme linguistike demonstronjë një lidhje midis metaforës konceptuale dhe hamendësimit të folësit në të kuptuarit e shprehjeve të ndryshme verbale, siç janë të sugjeruara nga hipoteza 2 dhe 3 (Lakoff, 1987: 89; Lakoff & Johnson, 1980: 56).

Shumë eksperimente psikolinguistike përkrahin pretendimet në hipotezën 3 se mendimet metaforike motivojnë dukurinë, sepse shumë fjalë dhe shprehje kanë domethënie e duhur për folësit bashkëkohorë dhe gjithashtu i shtyn njerëzit të mësojnë kuptime të ndryshme linguistike (Gibbs, 1994). Gjithsesi është ende e paqartë kur mendimi metaforik është i pranuar në prodhueshmërinë imediate dhe në

perceptimin (kapjen) e kuptimit linguistik (hipoteza 4).

Shumë studiues të gjuhës nuk i shohin idiomat si prodhime metaforike, sepse këto fraza janë shembull klasik i metaforës së vdekur (Gibbs, 1993: 54; 1994: 63). Idioma së pari duhet të ketë qenë shprehje metaforike, që me kalimin e kohës e ka humbur metaforshmërinë dhe tani ekziston e gatshme, si njësi leksikore në fjalësin mendor.

### 5. Këndvështrim i ngushtë për idiomaticitetin

Mund të kemi edhe një vlerim më të ngushtë mbi idiomaticitetin. Njeriu që kërkon përgjithësim të rëndësishëm përmes frazave idiomatike, zbulon se idiomat nuk ekzistojnë si njësi të ndara brenda leksikut, por aktualisht reflektojnë sisteme koherente të metaforës konceptuale. P.sh. frazat idiomatike si *Blow your stack* / të kalosh në fazë, të çmendesh; *Flip your lid* / të humbasësh durimin; *To loose your temper* / të bëhesh nevrík; *Get hot under collar* / të nxelesh edhe me ato që ke veshur; *To lose your cool* / të humbasësh gjakftohtësinë; *Get steamed up* / të të shkojnë djersë të ftohta.

Në anglishte shfaqen me qindra a mijëra idiomat të motivuara nga metafora konceptuale, si "*anger is a heated fluid*", e cila është njëra prej idiomave në hartën e metaforës konceptuale që merr pjesë në konceptimit tonë për "*anger / zemërim*".

Prania e këtyre metaforave konceptuale të siguron një motivim, se për ç'arsye disa shprehje specifike (p.sh., *blow your stack* / të kalosh në fazë) janë përdorur për t'iu referuar evenimenteve të veçanta.

Evidenca të ndryshme psikolinguistike përkrahin idenë që metaforat, siç është "*anger is a heated fluid in a container*" në janë me të vërtetë konceptuale ose jo, akoma më thjeshtë, janë përgjithësim të kuptimeve linguistike. Kjo përfshin studimet që janë parë në imagjinatën mendore të njerëzve për idiomat (Gibbs & O'Brien, 1990: 43), në përdorimin e përpiktë e të vazhdueshëm të idiomave (Nayak & Gibbs, 1990: 28; 1991: 39) dhe të frazave eufemistike (Pfaf, Gibbs & Nayak në shtyp), në kuptimin e të folurit të përditshëm të njerëzve se si sfera burimore

për metaforën konceptuale detyron atë çka idiomat duan të thonë (Gibbs 1992), në përdorimin e metaforës konceptuale për organizimin e informacionit në procedimin e teksteve (Allbritton & Gerrig, 1995: 27) dhe në përdorimin e metaforës konceptuale në hartimin e përfundimeve kur interpretohen dhe shpjegohen metaforat poetike (Gibbs & Nascimento, 1996: 73). Të gjitha këto gjetje psikolinguistike të japin besim *mbi 4 hipotezat* se pjesë të ndryshme të mendimit metaforik, në mënyrë të pjesshme shpjegojnë se pse disa metafora dhe idioma kanë kuptimin që ato shfaqin për folësin bashkëkohor (*Hipoteza 3*). Megjithëse metaforat konceptuale duket të jenë të ndikuara në shumë aspekte jetësore nga ajo se shumë njerëz i marrin me mend kuptimet idiomatike. Disa studiues kanë kritikuar afërsitë e metaforës konceptuale, si teoria e metaforës imediate dhe ajo e kuptimit idiomatik (Glucksberg & Keysa, 1990: 31; Glucksberg & Glone & Graessar, 1991: 98; Glone, 1993: 89; 1996: 64). Këto kërkime argumentojnë se, edhe pse hartimi i depozituar për metaforën në tru ka mundësi të jetë i vlefshëm, njohuri të tilla mund të mos jenë gjithnjë të pranueshme dhe të përdorshme në çdo kontekst të dhënë. Nën këtë mëtim mund të jetë vërtetë *hipoteza 3*, por kursesi *Hipoteza 4*.

Një tërësi studimesh të kohëve të fundit, për shembull, tregojnë se metafora konceptuale influencon gjykimin e njerëzve për përshtatshmërinë e idiomave në kontekste të ndryshme, por nuk janë të pranueshme përgjatë kuptueshmërisë imediate të idiomave, të paktën siç janë testuar nga "Global reading Times / koha që u është dhënë njerëzve për të lexuar" rreth idiomave në kontekste të ndryshme metaforike (Gibbs, 1993). Megjithatë, Gibbs (in press / në shtyp) dështoi kur u përpoq të gjejë më shumë kohë për leximin e idiomave në kontekst, të cilat pikturonin të njëjtin konceptim metaforik. *Pfaf et al (in press)* gjeti në detyrën për frazat e plota idiomatike se eufeizmat në kontekst kuptoheshin më lehtësisht sesa metaforat konceptuale.

Papajftueshmëritë për këto kërkime sugjerojnë se "Global reading time / koha që u është dhënë

njerëzve për të lexuar e kuptuar", mund të mos i sigurojë metodat më të mira për të vlerësuar se kur metaforat konceptuale janë të pranueshme përgjatë kuptueshmërisë idiomatike imediate.

Qëllimi ynë për sa trajtuam deri tani ka qenë që të demonstrojmë se metaforat konceptuale janë shumë të lidhura me idiomat leksikore dhe shpesh janë të identifikueshme sidomos kur idiomat strukturalisht janë të motivueshme dhe shfaqen me kuptim të mëvetësishëm.

## 6. Eksperimenti

Eksperimenti parapëlqen një test që do të hulumtonte idenë se metaforat konceptuale ndihmojnë dukshëm kuptimin e idiomave. Pjesëmarrësit në eksperiment lexuan një histori të imagjinuar si Stimuli në Eksperimentin 1. Këtë herë historia përfundoi në një rën prej 2 frazave idiomatike, që shprehnin përafërsisht të njëjtin kuptim figurativ. Për shembull, një histori e një personi që nxehet e nevrkoset (getting angry) për shkak të disa evenimenteve përfundonte ose në *blew your stack (humbas durimin)* ose *jumped down your throat (të preva gurmazin / ta hodha gurmazin në shesh)*.

Menjëhere pas leximit të frazave finale të çdo historie, pjesëmarrësit bënë vendosjet leksikore mbi fjalën e shenjuar ose të pashenjuar. Fjalja e shenjuar reflektonte një metaforë konceptuale që motivonte vetëm një rën prej idiomave. Kështu *heat* reflektonte metaforën *anger is a heated fluid in a container*, e cila motivon *blew his stack (humbas durimin)*; ndërkohë që idioma tjetër *jump down his throat* është e motivuar nga një metaforë tjetër, *anger is animal behaviour*.

Në qoftë se metaforat konceptuale gjatë përpunimit idiomatik janë shumë shpejt të pranueshme, atëherë të anketuarit do të ishin më të shpejtë në marrjen e vendimit për një idiomë të nënvizuar metaforike lidhur me fjalët e shenjura leksikore në vazhdim se sa kur ata lexojnë një idiomë me kuptim të njëjtë figurativ, por që është e motivuar nga një metaforë tjetër konceptuale. Gjithsesi, kur njerëzit lexojnë idiomat e motivuara nga metafora konceptuale e pavazhdueshme me fjalinë shenjuese / konsistente dhe me ato joshenjuese /

jokonsistente, duhet të jenë të përcaktuar se ato nuk mund të ndryshojnë me shpejtësinë, me të cilën njerëzit i bëjnë zgjedhjet leksikore.

Eksperimenti 2 parashikonte një bashkëveprim në zgjedhjen leksikore ekzistuese, midis shprehjes përmbyllëse (d.m.th midis idiomës vazhduese dhe idiomës jovazhduese) dhe objektivit të shenjuar (d.m.th fjalisë shenjuese dhe joshenjuese).

## 7. Metodat

Si *subjekte* u morën përsëri studentë të diplomuar nga Universiteti i Santa Cruzit. Të gjithë ishin folës autoktonë të gjuhës angleze dhe askush prej tyre deri atëherë nuk kishte shërbyer si subjekt në eksperimentime.

1. *Stimuli dhe sheshtimi*. Stimuli primar për këtë studim ishin 16 histori që përshkruanin evenimente ordinere. Çdo histori përfundonte me një ose me dy shprehje idiomatike, të cilat shprehnin kuptim të njëjtë figurativ (p.sh. *to get very angry* / të nevríkosesh shumë). Një idiomë (p.sh. *blow your stack* / të humbasësh durimin) u njoft si e motivuar nga një metaforë konceptuale (p.sh. *si anger is heated fluid in a container*), ndërkohë që idiomat tjetër ishte e motivuar nga një tjetër vështrim metaforik (p.sh. *anger is animal behaviour*).

Idiomat e motivuara nga e njëjta metaforë konceptuale të reflektuara në fjalët shenjuese ishin fraza konsistente (të vazhdueshme), ndërkohë që idiomat e motivuara nga një metaforë tjetër konceptuale ishin fraza jokonsistente (jo të vazhdueshme). Dhjetë nga kontekstet e historive ishin të marra drejtpërdrejt nga Eksperimenti 1. Këto histori përfundonin në idioma për të cilat ishte relativisht e lehtë të gjeje një idiomë shtesë me kuptim të njëjtë figurativ, por që ishin të motivuara nga një metaforë tjetër konceptuale. Përveç kësaj, këto histori ishin të shkruara me një stil asnjans, që të mos sillnin ndonjë informacion tjetër specifik.

Gjithashtu, të pesë historitë e shkruara për këtë studim përfundonin me njëerën prej dy idiomave, që përsëri të dyja veçmas shprehnin kuptime figurative të njëjta, por që ishin të motivuara nga metaforat e ndryshme konceptuale.

Përmes 14 historive, idiomat konsistente kishin 19.1 karaktere gjatësi dhe idiomat jokonsistente 20.9 karaktere gjatësi. Marrë së bashku ky studim përfshinte 2 tipat idiomatikë (konsistentë dhe jokonsistentë) dhe 2 objektiva (shenjuesin dhe joshenjuesin).

Disa norma studimesh ishin të drejtuara me pjesën e eksperimentit *stimuli*. Rezultatet për këtë treguan se mbi të gjitha, idiomat konsistente (3.81) dhe jokonsistente (3.74) në çdo histori ishin të njohura. Një tjetër detyrë e dytë u kërkuar pjesëmarrësve të njëjtë të gjykonin për çdo kontekst historie ngjashmëritë midis idiomave konsistente dhe atyre jokonsistente.

Më pas u vërejt, në këtë studim, se i njëjti grup pjesëmarrësish zgjodhi një fjalë për secilën idiomë të re të përdorur si *stimul*, të cilat së bashku, reflektonin më mirë metaforën konceptuale motivuese të nënvizuar për idiomën e dhënë. Nga kjo procedurë, u gjet se 80% e pjesëmarrësve ishin dakord në një fjalë të vetme si paraqitsja më e mirë e metaforës konceptuale për fraza të ndryshme idiomatike.

## 8. Rezultate dhe diskutime

Të dhënat u analizuan në të njëjtën menyrë si në studimet e para. Analizat mbi këto gjetje demonstuan se studentët pjesëmarrës praktikisht, në të dyja rastet, kur këta qenë të ndjekur nga objektivi konsistent dhe nga ai jokonsistent morën kohë të njëjtë të frazave finale.

Testimet e kohës së zgjedhjeve leksikore treguan një efekt domethënës. Testet Newman & Keuls zbuluan se pjesëmarrësit ishin më të shpejtë në përgjigje me anë të metaforës, pasi kishin lexuar idiomën konsistente sesa kur kishin lexuar atë jokonsistente. Këto të dhëna treguan se njerëzit kur lexojnë idiomat, të cilat janë pjesërisht të motivuara nga metafora konceptuale të ndryshme (të nënvizuara) nuk pranojnë menjëherë informacion të njëjtë metaforik, edhe pse këto fraza mund të kenë kuptim të njëjtë figurativ.

Qëndrimet e disa gjuhëtarë për mënjanimet nga rregullat gramatikore të së shkuarës, tashmë janë pranuar. Por duhet shtuar se jo vetëm në gjuhën

e folur, po edhe në gjuhën e shkruar DUHET pranuar ndryshime të tilla që çojnë në ndryshime në rrafshin emërtues dhe që hapin rrugë për krijime të reja frazeologjike a idiomatike.

#### **BIBLIOGRAFIA**

ALLBRITTON, D.W., MC KOON, G., & GERRIG (1995), *The effect of Metaphor in reading process*, Hillsdale, New York.  
GIBBS & NASCIMENTO (1996), *Conceptual Metaphor Comment. Mixing memory*, Bruksel.  
GIBBS & O'BRIEN (1990), *Cognition-idioms & mental imagery*, Londër.  
GIBBS (1992), *Metaphor in Idiom Comprehension*, Londër.  
GLUCKSBERG & KEYSA (1990), *Comprehension of Metaphors and Similies*. Quincy.  
GLUCKSBERG, KEYSA & MC GLONE, (1992), *Intuitions of the transparency of idioms*, Birckberg College, London.

HENDERSON (1982), *Metaphor and translation*, Woodstock, New York.  
JOHNSON (1987), *The body and mind in cognitive linguistic*, Univeristeti i Floridës.  
LAKOFF & JOHNSON (1980), *Towards a theory of reading & understanding*. Universiteti i Chicagos, Departamenti i Socilinguistikës.  
LAKOFF (1987), *Mental models*, Blackwell.  
MC CLOSKEY (1983), *Naive prediction of motion and orintation in mirrors*, Stanford, Londer.  
MC GLONE (1993), *What is the explanatory value of a conceptual metaphor?* Universiteti i Michiganit.  
MC GLONE (1996), *A variety of experimental paradigm*, Universiteti i Michiganit.  
NAYAK & GIBBS (1990), *Relevance Theory and the construction of idiom meaning*. Boston (MA).  
NAYAK & GIBBS (1991), *Metaphor in cognitive linguistics*, Cambridge, University Press.  
THOMAI, Jani (1981), *Çështje të frazeologjisë në gjuhën shqipe*, Tiranë.